

V E N D I M

Nr.34, datë 7.1.1999

PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE DHE TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA

(Ndryshuar me VKM nr. 768, datë 26.12.2018; nr. 563, datë 8.10.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare¹ është person juridik në vartësi të Këshillit të Ministrave. Ajo zhvillon veprimtarinë e saj me vetëfinancim në përputhje me ligjin për ndërmarrjet dhe për veprimtari të veçanta e specifike subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Drejtori emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri.

2. Detyrat kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare janë:

a) kryen shërbime qeveritare të pritjes së delegacioneve të huaja, të personaliteteve të larta, të miqve e dashamirësve të vendit tonë etj., të cilët vijnë të ftuar nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave.

b) trajton me kushte banimi e ushqimi delegacionet e rangjeve të larta, që vijnë në ministri e institucione qendrore.

c) trajton e plotëson nevojat jetësore të personaliteteve të larta shtetërore të përcaktuara në këtë vendim.

d) plotëson kushtet e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë shtetërore, si të mbledhjeve, konferencave, seminareve, veprimtarive ndërkombëtare etj., që kryhen në mjediset e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

e) në përputhje me aktet ligjore në fuqi ajo kryen aktivitetet tregtar siç është: dhënia me qira e vilave, objekteve që ka në administrim, si dhe kryen veprimtari ekonomike të turizmit e të shërbimeve hotelieri për persona fizikë e juridikë vendas e të huaj. Për nevoja të veçanta në rrethet ku nuk disponon rezidenca apo vila, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mund të marrë objekte me qira nga subjekte shtetërore apo private, vendas apo të huaj.

ë) ushtron funksionin e organit qendror blerës për blerjen e biletave në fushën e transportit ajror, si dhe rezervimin, blerjen e shërbimeve të akomodimit në hoteleri jashtë vendit dhe siguron shërbimet logjistike shtesë për delegacionet shtetërore jashtë vendit, për Kryeministrinë dhe ministrinë. Për Kabinetin e Kryeministrit, institucionin e Presidencës dhe Kuvendit të Shqipërisë, këto shërbime i ofrohen në rast se kërkojnë prej tyre. Shpenzimet për kryerjen e këtyre shërbimeve mbulohen nga buxhetet e institucioneve përfituese. DSHQ-ja negocion kontrata kuadër me kompani ajrore, rrjete

¹ Vendimi nr. 563, datë 8.10.2025, botuar në F.Z nr. 185, datë 10.10.2025 në Kreun II shprehet: "II. Funksioni i DSHQ-së për blerjen e biletave në fushën e transportit ajror, si dhe rezervimin, blerjen e shërbimeve të akomodimit në hoteleri jashtë vendit, i shtuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të zbatohet duke filluar nga data 1 janar 2026. Deri në atë datë, institucionet e përmendura në atë pikë duhet të kryejnë vetë procedurat përkatëse dhe brenda datës 10 dhjetor 2025 të dërgojnë pranë DSHQ-së të gjitha nevojat e tyre për periudhën 1 janar 2026 dhe në vijim."

hoteliere dhe agjenci udhëtimi dhe nënshkruan kontrata konfidencialiteti, me qëllim ruajtjen e informacionit të detyrueshëm mes palëve në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit përkatës. Me çdo institucion, i cili do të marrë shërbimin sipas kësaj shkronje, DSHQ-ja nënshkruan aktmarrëveshje bashkëpunimi dhe konfidencialiteti, me qëllim ruajtjen e informacionit të detyrueshëm mes palëve, në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit përkatës. Detyrat dhe përgjegjësitë e DSHQ-së për përmbushjen e detyrimeve për ofrimin e shërbimeve, si organ qendror blerës të përcaktuar në këtë shkronjë, si dhe tarifat e shërbimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues.

Institucionet e lartpërmendura dërgojnë në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare kërkesat për blerje të biletave dhe akomodim në hoteleri, jo më vonë se 15 ditë nga data e udhëtimit. Në raste emergjence dhe të justifikuara me shkrim nga institucioni kërkuar, mund të procedohet me kërkesën, e cila duhet të dorëzohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e udhëtimit. Në raste përjashtimore, DSHQ-ja mund të realizojë shërbimin në afate më të shkurtra se më sipër, me miratimin nga titullari i institucionit.

f) në objektet e saj, ku ka organizuar restorante, trajton kundrejt pagesës edhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët e Kuvendit dhe titullarët e institucioneve të tjera qendrore. Rregullat e caktimit të çmimeve miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

g) kryen veprimtari shitblerjeje, veprimtari prodhimi me porosi, riparim shërbime, shërbime me taksë dhe veprimtari të tjera të kësaj natyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

k) Mbulon funksionet e "Shërbimeve ndaj Trupit Diplomatik të akredituar në Tiranë dhe përfaqësive diplomatike shqiptare të akredituara jashtë vendit", nëpërmjet drejtorisë përkatëse në varësi të saj;

l) Menaxhon, administron dhe mirëmban godinat qeveritare, që gjenden në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të Këshillit të Ministrave, duke përfshirë planifikimin, organizimin funksional të hapësirave, rikonstruksionin dhe mobilimin, sipas nevojave të institucioneve publike;

ll) Inventarizon dhe regjistron pasuritë, që gjenden në listën e inventarit të Këshillit të Ministrave, duke krijuar një regjister qendror për të gjitha godinat qeveritare, duke përfshirë të dhëna mbi sipërfaqen, destinacionin, gjendjen teknike, vitin e ndërtimit dhe statusin ligjor;

m) Realizon procesin e mirëmbajtjes e të restaurimit në godinat qeveritare që gjenden në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të Këshillit të Ministrave, ndërhyrjet kapitale për rikonstruksione e restaurime, si dhe merr masa për sigurinë teknike e mbrojtjen nga zjarri;

n) Harton plane për menaxhimin me efikasitet të energjisë së godinave qeveritare që gjenden në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim edhe me institucionet përgjegjëse shtetërore dhe kujdeset për integrimin e standardeve 'green building';

nj) Ushtron funksionin e organit qendror blerës për blerjen e mobilie, arredimin/ ambientimin e mjediseve të punës dhe përfaqësimit për llogari të Kryeministrit, ministrave, si dhe të përfaqësive diplomatike të akredituara jashtë vendit. Për institucionin e Presidencës dhe Kuvendit të Shqipërisë, këto shërbime i ofrohen në rast se kërkohen prej tyre. Administron, mirëmban dhe restauron mobilie dhe objekte dekorative me vlerë historike dhe artistike, që përdoren nga institucionet shtetërore, duke krijuar një fond kombëtar mobiliesh dhe objekteve dekorative (koleksion shtetëror);

o) Kryen procedurat e ankandit publik për shitjen e mobilie dhe objekteve dekorative të amortizuara e të panevojshme dhe merr pjesë në ankande për blerjen e mobilie dhe objekteve dekorative me interes historik, artistik dhe estetik, duke respektuar rregullat, procedurat dhe përjashtimet e legjislacionit në fuqi;

3. Shpenzimet e përcaktuara në pikën 2, shkronjat "a", "b" dhe "ë" të këtij vendimi, përballohen nga institucionet përkatëse.

4. Rezidencat qeveritare, vila dhe objektet e tjera në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndryshimi i emërimit nga rezidenca qeveritare në vila e anasjelltas, si dhe kalimi i tyre në administrim të bashkive e të këshillave të rretheve, bëhet me urdhër të Kryeministrit.

5. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, kur është e nevojshme mund të përdorë për veprimtarinë e mësipërme edhe nga objektet, që janë të klasifikuara rezidenca qeveritare.

6. Për kryerjen e riparimeve, rikonstruksioneve, mobilimin dhe pajisjen e rezidencave, vilave dhe objekteve të tjera, veç fondeve të planifikuara nga buxheti i shtetit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mund të bashkëpunojë edhe me persona juridikë e fizikë vendas e të huaj, në përputhje me dispozitat ligjore. Ky bashkëpunim mund të shtrihet edhe për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si dhe për përdorimin më me efektivitet të pasurisë që administron.

7. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare kryen shërbime kundrejt pagesës për pritjet zyrtare e jozyrtare, dreka e darka që jepen në objektet e saj sipas kërkesës së bërë. Shpenzimet e kryera përballohen nga institucionet përkatëse.

8. Pritjet e të gjitha kategorive bëhen me autorizim me shkrim të titullarit të organit, që e ka në kompetencë dhe vërtetohen nga persona zyrtarë të autorizuar prej tij, të cilët përcaktojnë e përgjigjen për kategorinë e delegacionit dhe kuotën e trajtimit të tyre.

9. Tarifat minimale për vilat e objektet, që jepen me qira nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, miratohen nga Këshilli i Ministrave, kurse vetë Drejtoria, në vartësi nga kërkesa e oferta, mund t'i rritë ato pa asnjë kufizim.

10. Tarifat e fjetjes dhe rregullat për caktimin e çmimeve në valutë e në lekë të mallrave e të artikujve të veprimtarisë tregtare të shitblerjes e të turizmit dhe marzhet sipas llojeve të prodhimit e të tregtimit, të shërbimeve qeveritare etj., miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare.

11. Presidenti i Republikës, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit dhe familjet e tyre, trajtohen sipas përkatësisë nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, institucionet përkatëse dhe Klinika Qeveritare për kushtet jetësore të banimit, pushimit, furnizimit me artikuj ushqimorë e industrialë, shërbimit mjekësor dhe personel shërbimi etj., si në rastin kur banojnë në rezidenca qeveritare ashtu dhe kur ata banojnë në apartamentet e tyre. Trajtimi me ushqime të bëhet me kosto, duke iu llogaritur në pagesë vetëm vleftën e lëndës së parë.

12. Personalitetet e mësipërm, iu vihet në përdorim për banim nga një rezidencë, në administrimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, i pajisur në mobilie dhe inventar përkatës, në përputhje me mjediset e banesës.

Kur personalitetet e lartpërmendur banojnë në apartamentet e tyre Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare pajis me mobilie dhe inventarin përkatës vetëm dhomën e pritjes dhe atë të punës, të cilët mbeten si inventar i kësaj Drejtorie.

13. Për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare përballon këto shpenzime:

a) për mirëmbajtjen e rezidencave qeveritare dhe mjediseve të tjera rrethuese, për kompletimin me mobilie e orëndi, pajisje e mirëmbajtjen e tyre, kur banojnë në rezidencat qeveritare, të parashikuara në pikën 13 të këtij vendimi.

b) për mbajtjen e personelit të nevojshëm të shërbimit për secilin personalitet sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur, si kur banojnë në rezidencat qeveritare ashtu dhe kur personalitetet banojnë në apartamentet e tyre.

c) për qira, ujë, energji elektrike e ngrohje, në rezidencat qeveritare apo në apartamentet e tyre.

d) për bisedime e lidhje telefonike në rezidencat qeveritare apo në apartamentet e tyre.

14. Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe familjeve të tyre në kohën e pushimit, iu vihet në dispozicion nga një apartament në rezidencat që administron Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare në qendrat e pushimit.

Shpenzimet për qira, ujë, energji elektrike, ngrohje, lidhje telefonike etj., përballohen nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, ndërsa shpenzimet për ushqimin përballohen sipas kritereve të përcaktuara në pikën 12 të këtij vendimi.

15. Ish-Presidentit të Republikës për një periudhë 4-vjeçare nga mbarimi i mandatit, ish-Kryeministrit dhe ish-Kryetarit të Kuvendit për një periudhë 2-vjeçare nga mbarimi i mandatit, zëvendëskryeministrit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, për kohën e pushimit iu vihet në dispozicion sipas mundësive, apartament në rezidencat dhe vilat që administrojnë Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, kundrejt tarifave të caktuara nga kjo drejtori.

16. Shpenzimet që bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe nënkryetarët e Kuvendit për pritjet, dreka e darka zyrtare, që jepen nga këto personalitete, si dhe shpenzimet për kafe, që bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, përballohen nga fondet e vetë institucioneve, që përfaqësojnë autoritetet e lartpërmendura.

17. Për kryerjen në kohë e me cilësi, të gjithë veprimtarisë së përcaktuar në këtë vendim, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare ngarkohet të blejë mallra me cilësi të lartë, sipas rregullave ligjore e nënligjore për prokurim publik, ndërsa për nevoja të domosdoshme lejohet të kryejë pagesë me lekë në dorë deri në 200 000 (dyqind) mijë lekë në ditë.

18. Për artikujt ushqimorë dhe industrialë, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të furnizohet me përparësi, kundrejt pagesës, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 “Për administrimin e sendeve, që kalojnë në dobi të shtetit, nga kundërvajtjet administrative”.

19. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të hartojë rregulloren e brendshme, e cila miratohet nga këshilli i saj drejtues.

20. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.361, datë 21.9.1991 “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”, pikat 1,2,3,4 dhe 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.404, datë 24.10.1991, vendimi nr.485, datë 29.7.1996, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 8.10.1996, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Lidhja nr.1

LISTA E PERSONELIT TË SHËRBIMIT

I. Për Presidentin e Republikës

1. Kuzhinieri	Nr. i Punonjësve	1
2. Kameriere	“	1
3. Punëtor pastrimi	“	1

II. Për Kryeministrin

1. Kuzhinieri	Nr. i Punonjësve	1
2. Punëtor pastrimi	“	1

III. Kryetarin e Kuvendit

1. Kuzhinieri	Nr. i Punonjësve	1
2. Punëtor pastrimi	“	1

Shënim: Personeli tjetër teknik sigurohet sipas nevojave nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare

**REZIDENCAT QEVERTARE, VILAT DHE OBJEKTET E TJERA NË
ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE**

I. Për rrethin e Tiranës

1. Pallati i Brigadave me të gjitha anekset e territorin përreth.
2. Shtëpia e Pritjes nr.4 me gjithë territorin përreth
3. Objekti nr.5 me gjithë territorin përreth.
4. Pallati i Kongreseve me gjithë territorin përreth.

5. Vila nr.30 me gjithë territorin përreth.
6. Vila nr.31 me të gjitha anekset e territorin përreth.
7. Bar Restorant “Tirana” dhe serat.
8. Objekti nr.32/1 me gjithë territorin përreth.
9. Objekti nr.42.
10. Grupi i vilave gjermane dhe territori përreth.
11. Magazinat industriale dhe territori përreth.
12. Parku i mjeteve të drejtorisë.
13. Berberi dhe kioska industriale.
14. Shtëpia e Pritjes nr.1 në Dajt dhe territori përreth.
15. Shtëpia e Pritjes nr.2 në Dajt dhe territori përreth.

II. Për rrethin e Durrësit

1. Vila kodër dhe territori përreth.
2. Vila nr.5 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
3. Vila nr.6 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
4. Vila nr.11 në Plazh Durrës e territori përreth.
5. Vila nr. 13 në Plazh Durrës e territori përreth.
6. Vila nr.18/1 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
7. Vila nr.20 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
8. Vila nr.23 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
9. Vila nr.29 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
10. Vila nr.30 në Plazh Durrës dhe territori përreth.
11. Restoranti (Stabilimenti i ri).
12. Kaldaja.
13. Godina e zyrave.
14. Godina e repartit ushtarak.
15. Sera, mjediset e shërbimit pranë vilës nr.5 e 23 e territori i gjelbëruar përreth bllokut të vilave.

III. Për rrethin e Pogradecit e Korçës

1. Vila nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, si dhe territori përreth, brenda rrethimit.
2. Klubi Pogradec.

3. Godina e Gardës.
4. Vila nr.2 në Korçë e territori përreth.

IV. Për rrethin e Vlorës

1. Vila nr. 1 e territori përreth, përfshirë anekset për plazh.
2. Vila nr.2 e territori përreth.
3. Vila nr.6 e nr.9 e territori përreth.
4. Vila në Dhërmi e territori përreth.

V. Për rrethin e Shkodrës

1. Shtëpia e Pritjes nr. 1 e territori përreth.
2. Shtëpia e Pritjes në Velipojë e territori përreth.

VI. Për rrethin e Elbasanit

1. Shtëpia e Pritjes e territori përreth.

VII. Për rrethin e Lushnjës

1. Shtëpia e Pritjes në Divjakë e territori përreth.

VIII. Për rrethin e Gjirokastrës

1. Shtëpia e Pritjes e territori përreth.

IX. Për rrethin e Sarandës

1. Shtëpia e Pritjes e territori përreth.